



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 4114 Prot

Tiranë, më 23.6.2016

URDHËR

Nr. 129, datë 23.6.2016

**PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE
TË SIPËRFAQVE NË ZONAT E MBROJTURA**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, Ligjit nr.9000, datë 30.01.2003
“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”

URDHËROJ:

1. Miratimin e procedures së dhënies në përdorim me kontratë qeraje të sipërfaqeve në zonat e mbrojtura referuar veprimtarive të përcaktuara në nenet 6, 12, 19, 25 dhe 33 të Ligjit Nr. 8906, datë 06.06. 2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar dhe miratimit të cituar në pikën 2, të kreut IV të VKM Nr. 382, datë 25.05.2016 “Për disa shtesa në VKM nr.102, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit e të organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, të ndryshuar”, sipas Aneksit bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Lefter KOKA

MINISTËR

ANEKS

1. Sipërfaqe (territore) të zonave të mbrojtura, jepen në përdorim me kontratë qiraje nëpërmjet procedurës pa konkurim publik për veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore, etj, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura" të ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 2, të Kreut IV të VKM Nr. 382, datë 25.05.2016 "Për disa shtesa në VKM nr.102, datë 4.2.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit e të organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", të ndryshuar.

2. Sipërfaqe (territore) të zonave të mbrojtura që jepen në përdorim sipas përcaktimit të pikës 1 janë:

- sipërfaqe me pyje;
- sipërfaqe me bimësi pyjore;
- sipërfaqe inproduktive;
- sipërfaqe kullosore/livadhe;
- sipërfaqe ujore.

3. Subjektet publike ose private që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në sipërfaqet e zonave të mbrojtura, mund të paraqesin kërkesën në formën e propozimit (format miniprojekti) në çdo kohë pranë AdZM-ve në territorin administrativ të të cilës ndodhet sipërfaqja që do të jepet me qera.

4. Kërkesa e subjektit, minimalisht duhet të përmbajë:

- Të dhënat e kërkuarit, gjeneralitetet, vendbanimin, adresën e saktë, pikën e kontaktit;
- Përshkrimin e hollësishëm të veprimtarisë që do të ushtrohet;
- Sipërfaqen dhe vendodhjen e veprimtarisë që do të ushtrohet;
- Miniprojektin për veprimtarinë që do të ushtrohet ku të shprehen; treguesit për ekosistemin, treguesit biologjik, natyror, mjedisor e turistik;
- Plan biznesin dhe investimet për zhvillimin e aktivitetit;
- Afatin e veprimtarisë.

5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës kryhet nga strukturat menaxhuese të AdZM-ve.

6. Në vlerësimin e projektit dhe kërkesës duhet të mbahen parasysh:

- Sipërfaqet mund të jepen vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenet 12 dhe 25 të Ligjit Nr. 8906, datë 06.06. 2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar dhe në nenet 15 e 17 të Ligjit Nr. 9693, date 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.

- Veprimtaritë që do të ushtrohen në këto sipërfaqe, të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me planin e menaxhimit të zonës si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Afati i dhënies në përdorim të jetë në përputhje me afatet e planit të menaxhimit, por jo më shumë se 5 vjet; në rast të mungesës së planit të menaxhimit ose të mos parashikimit të tyre, shqyrtimi do të bëhet duke marrë parasysh efektet ose ndikimi i aktivitetit në zonën e kërkuar.
- Projektet e veprimtaritë që do të ushtrohen duhet:
 - a. të sjellin përmirësime të dukshme në ekosistem dhe habitat, në mbarështimin e florës dhe faunës që ndodhen në këto sipërfaqe;
 - b. të realizojnë investime që përmirësojnë tregues biologjikë, mjedisor e turistik dhe të infrastrukturës së kësaj sipërfaqeje;
 - c. të mos cenojnë vlerat natyrore, mjedisore, turistike e biologjike dhe funksionet e tyre;
 - d. të jenë në përputhje me investimet publike që janë planifikuar të bëhen në zonë në vitet e ardhshme;
 - e. të jetë në përputhje me strategjinë e zhvillimit rajonal dhe atij kombëtar.

7. Në rast se kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 4 dhe 6 të këtij Aneksi, brenda 10 ditëve punë AdZM-ja, duhet të dërgojë propozimin për miratim në AKZM së bashku me dokumentacionin përkatës i cili duhet të përmbajë:

- a) sipërfaqen (territorin) e zonës së mbrojtur e shprehur në meter katror (m^2), me kufij të përcaktuar qartë në harta të shkallës 1:10000 ose 1:25000 (koordinatat gjeografike, metrike);
- b) përdorimin e tokës në sipërfaqen e zonës së mbrojtur të njehsuar (m^2), e cila cakton kategorinë e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm të saj, ekonominë pyjore/ kullimore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat, etj.;
- c) treguesit identifikues (kadastralë) të ngastrave ose nënngastrave;
- d) karakteristikat biologjike e mjedisore të bimësisë në territor;
- e) treguesit tekniko-ekonomik për kullotat dhe livadhet;
- f) treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të sipërfaqes (territorit) të zonës së mbrojtur që parashikohen të jepen me qira;
- g) Përlllogaritjen e vlerës së qirasë do të bëhet mbi bazën e raportit teknik, i cili do të jetë pjesë integrale e kontratës duke respektuar tarifat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;
- h) sipërfaqja e propozuar për t'u dhënë në përdorim të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;
- i) sipërfaqja e propozuar të mos jetë objekt tjetërsimi në një afat 10-vjeçar në rastet kur në to janë planifikuar investime publike.

8. Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 4 dhe 6 të këtij Anesi, brenda 10 ditëve punë AdZM-ja, duhet të kthejë përgjigje për mosvazhdim procedure kërkesit duke i argumentuar arsyet e refuzimit të kërkesës.

9. Në rast se arsyeja e refuzimit të kërkesës lidhet me mungesa të dokumentacionit referuar kërkesave të përcaktuara në pikën 4 të këtij Aneksi, kërkuuesi ka të drejtë që pas plotësimit të dokumentacionit të riparaqesë kërkesën për marrje me qera.

10. Pas shqyrtimit të propozimit të AdZM-së drejtuar AKZM-së, Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit në AKZM, shqyrton dokumentacionin përkatës dhe në qoftë se plotësohen kërkesat (kriteret) e këtij urdhëri, përgatit urdhrëin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së për miratimin e dhënies me qëra të sipërfaqes përkatëse pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura.

11. Kopje e urdhërit të miratimit të përcaktuar në pikën 10 mësipërm, i njoftohet AdZM-së që ka dërguar propozimin, për vazhdimin e procedurave deri në nënshkrimin e kontratës me kërkuuesin.

12. Pas nënshkrimit të kontratës mes kërkuuesit dhe Drejtorit të AdZM-së përkatëse, sipërfaqja i dorëzohet palës tjetër me procesverbal dhe në përfundim të afatit të kontratës i merret përsëri në dorëzim nga AdZM-ja, po me procesverbal.

13. Kontrata, pavarësisht kohëzgjatjes së saj, rinovohet çdo vit nga AdZM-ja përkatëse pasi të jetë verifikuar zbatimi në praktikë i të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të palëve.